



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-150269

Datë: 26.09.2024

Prizren

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e **ArcConstruction Sh.P.K. nga Prizreni** ne baze te nenit 3 paragrafi 1 pika 1.9, 1.24, 1.25 dhe 1.27, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2 nenpika 1.2.2 dhe nenit 1 6 te Ligjit Nr. 04/L-174 per planifikim hapësinor, nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1, 1.2, 1.4, 1.17 dhe 1.24 ne lidhje me nenin 5 paragrafi 1.1, e lihur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenin 19 paragrafi 2, te Ligjit Nr. 04/L – 110 per Ndertim, konform dispozitave të neneve 21, 22, 44, 46, 47, 48 e lidhur me nenin 86, si dhe nenin 125 dhe 127 të LPPA-së dhe nenin 85 të Ligjit Nr. 03/L-040 per Vetëqeverisjen Lokale, nenit 147, 148 paragrafi 1, nenit 149, të Vendimit komunal për rregullimin e qytetit dhe shërbimeve komunale, Nr. 1/011-2, të datës 18 nëntor 2004, si dhe konform Vendimit për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022-2030, Nr. 001/011-48192, të datës 31.03.2022, bie këtë:

## AKTVENDIM

§

**I LEJOHET ArcConstruction Sh.P.K. - : Vendorsjen e trafos në parcelën kadastrale P-71813068-07214-20 me pronar Şemail Bütüç , Pëlqimit Parimor me nr. 428 dt.23.04.2024 , Pëlqimit Elektroenergjetik- revidim dhe Zgjidhjes Teknike me nr.12913 dt. 13.09.2024 .**

- I. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë- i punuar nga ana e KEDS-it.
- II. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.
- III. Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave të përkohshme teknike për kësi llojë punime
- IV. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.
- V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit ligjor

**VI.** Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.

**VII.** Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtrojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.

**VIII.** Në qoftëse punimet në infrastrukturë nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkojë nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

**P.S. Problemet eventuale me fqinjët mbetet të zgjidhë investitori.**

**P.S.** Investitori gjatë implementimit të projektit duhet të përmbahet kushteve të zgjidhjes Teknike të KEDS-it me nr.12913 të dt.13.09.2024 dhe të gjitha punimet të realizohen nën mbikqyrjen e personave të autorizuar të KEDS-it gjithashtu është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit,kanalizimit, PTK, KEDS-it, K.R. U. "Radoniqi - Dukagjini"si dhe avari tjera ti evitojë dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.


### **A r s y e t i m**

**ArcConstruction Sh.P.K.nga Prizren është drejtuar këtij organi me kërkesë për Vendosjen e trafos në parcelën kadastrale P-71813068-07214-20 me pronar Şemail Bütüç , Pëlqimit Parimor me nr. 428 dt.23.04.2024 , Pëlqimit Elektroenergjetik- revidim dhe Zgjidhjes Teknike me nr.12913 dt. 13.09.2024 .**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI-së – Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:



Afërdita Mormorina, inxh. dip. ark.

Drejtori:



Pranverim Berisha, jur

